Kronikë

Mirditë/ Në kërkim për rrahjen e kunatit, por 51-vjeçari i sulmon edhe shtëpinë me breshëri plumbash! Shkak konfliktet familjare me vëllanë e gruas (EMRI)

Policia e Mirditës shpalli në kërkim 51-vjeçarin si autor të dyshuar të krimit. Nga hetimet paraprake rezulton se shënjestër ka qenë banesa e vëllait të gruas së tij dhe ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:30 të mëngjesit të sotëm. Edhe pse ishte në kërkim policor për rrahjen, u rikthye të sulmonte me armë banesën e kunatit

Komisariati i Policisë Mirditë

Redaksia
20 Qershor, 15:04 | **Përditesimi: 20 Qershor, 15:28**

Share

Mirditë- Pasi e dhunoi në një konflikt familjar, i sulmon me armë zjarri edhe shtëpinë gjatë natës kunatit të tij 30-vjeçar (vëllai i gruas).

Policia e Mirditës bëri me dije se shpalli në kërkim autorin e dyshuar të krimit, 51-vjeçarin Luan Vukaj. Nga hetimet paraprake rezulton se shënjestër ka qenë banesa e E. Ç., dhe ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:30 të mëngjesit të sotëm (20 qershor).

I riu njoftoi sallën operative të Komisariatit pas brëshërive të plumbave, kurse për fat të mirë nuk pati të lënduar, por vetëm momente terrori.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Lezhë/ Një zjarr masiv përfshin zonën pyjore të Malajt, dyshohet zjarrvënie e qëllimshme

> *"Menjëherë në vendngjarje shkuan shërbimet e Policisë dhe grupi hetimor. Nga kërqyrja u konstatua një dëmtim në murin e banesës, i shkaktuar nga përdorimi i armës së zjarrit. Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore, u bë i mundur identifikimi i autorit të dyshuar, shtetasi L. V., 51 vjeç, banues në fshatin Nerfushaz, i cili dyshohet se ka qëlluar në drejtim të banesës së shtetasit E. Ç., 30 vjeç", tha policia vendore.*

Policia sqaroi se autori është burri i motrës së shënjestrës dhe shkak ka qenë një konflikt familjar që kanë pasur mes tyre.

Nga verifikimet rezultoi se autori i dyshuar Vukaj, ishte shpallur në kërkim një ditë më parë (para sulmit me armë), pasi kishte ushtruar dhunë fizike po ndaj kunatit të tij.

> *"Vijon puna intensive për lokalizimin dhe kapjen e tij. Materialet procedurale i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme", sqaron policia vendore.*

A.Q/I.M/Shqiptarja.com

TAG: sulmi me arme | mirditë | Lezhë | luan vukaj

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
20 Qershor, 11:01
Çmimet më të larta se në BE, a mendoni se duhet të ndërhyjë qeveria?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Lezhë/ Qindra banorë mbeten pa energji në Fushë-Kuqe dhe Shenkoll, shkak djegia e transformatorit në nënstacionin elektrik
21 Qershor, 20:40

PERSONAZH/ Njihuni me mekanikun turk, që është bërë më mirditor se mirditorët: Punoj prej 10 vitesh këtu dhe i njoh të gjithë, më ofrojnë kafe
Elvis Hila
21 Qershor, 15:49

Vëzhgimi i Report Tv/ Plazhet publike të Vlorës mes plehrave dhe betonit të Lungomares! Në Shëngjin kushte më të mira, por me pagesë
Armand Xhelili
Elvis Hila
21 Qershor, 14:47

Policia 'matje' në Shëngjin, niveli i muzikës brenda normave (VIDEO)
21 Qershor, 10:12

Rrëshen/ Ushtroi dhunë psikologjike ndaj babait, nis hetimi për të birin! E pëson edhe një mjek, çoi të moshuarin në Spitalin Psikiatrik pa dokumentacion
20 Qershor, 11:07

Rama prezanton skuadrën fituese të Lezhës për Shqipërinë 2030 në BE
20 Qershor, 10:47

'Gucci e Armani'/ Sekuestrohen 75 mijë euro veshje me etiketa false në Lezhë! Në hetim pronarja e dyqanit
19 Qershor, 13:24

Stani i drogës në Kashnjet, Prokuroria mbyll hetimet dhe çon dosjen për gjykim, të pandehur vëllai i deputetit të PS dhe 2 të tjerë
19 Qershor, 11:13



Kolegji Zgjedhor 'certifikon' zgjedhjet në 4 qarqe, rrëzohen ankimet e PD në Lezhë, Kukës, Korçë e Gjirokastër! Logut s'i 'del' e keqja me Rusmalin
Danjela Maloku
18 Qershor, 11:18



Murtaja te bagëtitë, Përgjegjësi i Autoritetit të Veterinarisë në Lezhë: Kemi kryer kontrolle në të gjithë zonën! Masa ndëshkuese për ata që i nxjerrin nga ferma
Elvis Hila
17 Qershor, 12:26

Tradita/ Nga fëmijët tek të moshuarit, banorët e Zhejës në Kurbin vendosen në role për të risjellë ritet e dasmës si 100 vite më parë
Elvis Hila
16 Qershor, 16:11

E rëndë në Balldre, i moshuari bie në pus dhe humb jetën (EMRI)
16 Qershor, 15:04

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Gerllutka

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje